



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I EKONOMISË
DEPARTAMENTI I EKONOMIKSIT

Rregullore e Programit të Nivelit të dytë të Studimit në: Master Shkencor në Ekonomiks

1. Dispozita të Përgjithshme

1. Kjo rregullore bazohet në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimin e MASH, për çeljen e Programeve të Studimit në Diploma të Nivelit të Dytë si edhe në
 2. Ligjin nr. Nr.10 307, datë 22.7.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar në të cilin theksohet: **Studimet e ciklit të dytë janë:** 1.2.1. Programet e studimeve “**Master i shkencave**” ose “Master i arteve të bukura”:
 - a) programet e studimeve të ciklit të dytë i pajisin të diplomuarit që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor në një fushë, brenda një specialiteti;
 - b) programet e studimeve të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite, ku përfshihen 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;
 - c) studentët e këtij programi studimi **duhet të japin në përfundim edhe provimin e gjuhës angleze**, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare;
 - d) në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të dytë lëshohet diplomë universitare “Master i shkencave” ose “Master i arteve të bukura” në fushën e arsimimit të kryer.
 3. Gjithashtu kjo rregullore bazohet edhe në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit Ismail Qemali, sipas së cilës
 - Të drejtën e kontrollit akademik mbi këtë strukturë akademike e ka Përgjegjësi i Departamentit, Dekani i Fakultetit, Përgjegjësi i Degës Mësimore, Zv.Rektori akademik dhe Rektori i UV.
 - Të drejtën e kontrollit administrativ dhe financiar mbi këtë strukturë akademike e ushtron Dekani i Fakultetit, Kancelari dhe Rektori i UV.
 4. Financimi i programit të studimit Master i Shkencave në Ekonomiks realizohet nga tarifa e shkollimit të studentëve, nga burime financiare brenda Universitetit “Ismail Qemali” dhe/ose nga burime jashtë tij, bashkëpunuese në këtë program studimi.
 5. Kohëzgjatja e programit të studimit Master i Shkencave në Ekonomiks është 2 vite akademik, në përfundim të të cilit studenti fiton 120 kredite akademike.
 6. Regjistrimet në programin Master i Shkencave në Ekonomiks bëhen vetëm mbi bazën e një Diplome të Nivelit të Parë ose Diplome tradicionale
 7. Përzgjedhja e kandidatëve për programin e studimeve Master i Shkencave në Ekonomiks bëhet në bazë të Procedurave të vendosura nga Universiteti i Vlorës.
 8. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diploma: Master i Shkencave në Ekonomiks sipas modelit që figuron në pikën 8) të këtij dokumentacioni.
 9. Diploma e Master i Shkencave në Ekonomiks firmoset nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori i Universitetit “Ismail Qemali”.
 10. Diplomat Master i Shkencave në Ekonomiks, përpara se të lëshohen nga Universiteti “Ismail Qemali”, duhet të regjistrohen në regjistrin shtetëror të Diplomave dhe Çertifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, që mbahet në MASH, në bazë të Nenit 31 të Ligjit për Arsimin e Lartë.
2. Struktura Akademike Përgjegjëse për organizimin dhe menaxhimin administrativ e financiar të programit të studimit është Komiteti Shkencor, i zgjedhur nga FE, përbërja e te cilit u citua më lart.